



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:053673

Datë: 13.09.2024

Numri i dokumentit: 06160558

KPPP.nr. 348/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit "Saint Gobain Construction Products Albania" Sh.P.K., me NIPT L61822023H dhe seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga Atdhe Dika, avokat nga Prishtina, kundër debitorit "Gimi" Sh.P.K., me numër unik identifikues 810200113 dhe seli në Gjilan, rr. "Lidhja e Prizrenit", nr. 262, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 268/24 i datës 31.01.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 13.09.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit "Gimi" Sh.P.K., ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 268/24 i datës 31.01.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati, MBETET NË FUQI.
- II. DETYROHET debitori, që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej EUR 104.00 (njëqind e katër euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit "Saint Gobain Construction Products Albania" Sh.P.K., me datë 31.01.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 268/24, duke lejuar përmbartimin ndaj debitorit "Gimi" Sh.P.K., me seli në Gjilan, ashtu që është urdhëruar i njëjti, që në bazë të dokumenteve: Faturë nr. 0000006604 e datës 21.10.2022 dhe Faturë nr. 0000006695 e datës 28.10.2022, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 4,845.00 EUR (katërmijë e

tetëqind e dyzet e pesë euro) me kamatë ligjore prej 13.58%, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të urdhrin e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor me arsyetimin se përmbartuesi privat ka paraqitur obligime të debitorit ndaj kreditorit në vlerë prej 4,545.00 EUR e cila nuk qëndron për faktin se është kreditori ai që i ka borxh debitorit shumën prej 4,180.88 EUR, fakt ky që vërtetohet nga evidenca kontabël për periudhën nga data 01.01.2022 e deri më datë 31.12.2023. Në anën tjetër, ka shtuar se borxhi i debitorit sipas urdhrin përmbartimor P.nr. 269/24 të datës 31.01.2024 në shumë prej 11,180.17 qëndron, andaj nga kjo rrjedh se borxhi i tërësishëm i debitorit është në vlerë prej 6,999.29 EUR.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigjen në prapësim ka theksuar se debitori në prapësimin e tij nuk ka kundërshtuar marrëdhënien tregtare që kishte me kreditorin si dhe nuk ka kundërshtuar si të pranuar as faturat mbi bazën e të cilave është iniciuar procedura përmbartimore. Ka shtuar se shumën prej 4,845.00 EUR debitori e ka pranuar si të pa paguar, respektivisht e ka pranuar si borxh ndaj kreditorit përmes marrëveshjes së datës 09.05.2023, e cila nuk është paguar edhe pas nënshkrimit të së njëjtës. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi, si të obligohet debitori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbartimore në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumë prej 104.00 EUR.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar, andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet*

në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 0000006604 e datës 21.10.2022 dhe Fatura nr. 0000006695, e datës 28.10.2022, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjeti se përkundër që faturat e lart cituara nuk përmbajnë nënshkrimin e debitorit, të njëjtat kanë tipare të përmbareshmërisë nisur nga fakti se debitori, faturën nr. nr. 0000006604 të datës 21.10.2022 e ka paguar pjesërisht në shumën prej 3,483.18 EUR, fakt ky që vërtetohet edhe nga dëshmia bankare e datës 24.10.2022 e paraqitur nga debitori në prapësim, ndërsa faturën nr. 0000006695 të datës 28.10.2022, debitori e ka të evidentuar në librat e tij të kontabilitetit, fakt ky që vërtetohet nga pasqyra kontabël e ofruar nga vet debitori sipas prapësimit. Në ndërlidhje me këtë, gjykata gjeti po ashtu se palët ndërgjyqëse, me datë 03.05.2023 kanë nënshkruar marrëveshje për pagesën e borxhit në vlerë prej 4,845.00 EUR, shumë kjo që përputhet me shumën e papaguar të faturave objekt i këtij përbarimi, dhe atë me afat pagese deri më datë 12.08.2023, afat ky i cili nuk është respektuar nga debitori.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit se i njëjti ka përmbushur në tërësi obligimet që dalin nga këto dy fatura por që përveç përmbushjes së pjeshme të borxhit në vlerë prej 3,483.18 EUR, shumë këtë të cilin kreditori nuk e ka kërkuar me propozimin për përbarim, debitori nuk ka ofruar dëshmi konkrete se ka ekzekutuar pagesa edhe për pjesën e borxhit të mbetur në vlerë prej 4,845.00 EUR.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përbarimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet përfaqësuesit të kreditorit në emër të përgjigjes në prapësim të ushtruar në vlerë prej EUR 104.00, konform rregullores në fuqi për tarifën e avokatëve.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 348/24, datë 13.09.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.